



INSTITUCIONET E PËRKOSSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti I ministrit

Cabinet of the minister

Kabinet ministra

Datë: 26.07.2005

Udhëzim Administrativ Nr. 37/2005

Për rivendosjen e qeverisjes së ligjshme në Universitetin e Prishtinës

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,

Në përputhje me autorizimet që i janë dhënë nga Qeveria e Kosovës

Në përputhje me Nenin 4.1, paragrafet (b) dhe (m) të Ligjit mbi Arsimin e Lartë, dhe në bazë të Nenit 17, paragrafet (1) dhe (2) të Statutit të Universitetit të Prishtinës,

Duke pasur para sysh kronologjinë e implementimit të Statutit të UP-së, prej 9 korrik 2004,

Duke pasur parasysh parregullsitë ligjore në procesin e implementimit të Statutit të UP-së

Në përputhje me politikën e Qeverisë së Kosovës për të krijuar një gjendje të rregullt ligjore në Universitetin e Prishtinës

Në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës në mbledhjen e datës 26 korrik 2005 për rivendosjen e qeverisjes së ligjshme në udhëheqjen e Universitetit të Prishtinës,

Përmes këtij Udhëzimi Administrativ vendos si më poshtë:

- A. Procesi i implementimit të Statutit të Universitetit të Prishtinës kthehet prapa në datën 1 dhjetor 2004;
- B. Zgjedhjet e kryera pas kësaj date në UP shpallen të pavlefshme;
- C. Këshilli Drejtues i Universitetit (më tutje në këtë dokument “Këshilli”) do të plotësohet me katër anëtarë të emëruar nga MASHT brenda tri ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi;
- D. Këshilli do të konstituohet pa vonesë, do të zgjedh kryetarin dhe zëvendësin e kryetarit, si dhe do të miratojë rregulloren e punës në pajtim me dispozitat e Statutit;

Mbledhjen konstitutive të Këshillit e thërret Sekretari i Përgjithshëm i UP-së.

- E. Kompetencat administrative të Rektorit, do t’i barten përkohësisht, deri në zgjedhjen e rektorit të ri, një ekipi të përbërë prej tre zyrtarëve të lartë të Universitetit të Prishtinës: kryetarit të Këshillit Drejtues, Zëvendësit të Kryetarit të Këshillit Drejtues dhe Sekretarit të përgjithshëm të UP-së.
 - F. Zyrtari më i lartë i Universitetit, deri në zgjedhjen e rektorit të ri, do të jetë Kryetari i Këshillit; Zëvendëskryetari i Këshillit dhe Sekretari i përgjithshëm do të jenë zëvendës të Zyrtarit të Lartë të Universitetit.
 - G. “Zyrtari më i Lartë i Universitetit” dhe zëvendësit e tij do të vendosin me vendime unanime;
 - H. Në të gjitha rastet kur ka konflikt të kompetencave ndërmjet obligimeve të “zyrtarëve të lartë ngarkuar” dhe obligimeve të Këshillit, do të mbizotërojë qëndrimi i Sekretarit të përgjithshëm;
 - I. “Zyrtarët e lartë të ngarkuar” nuk do të involvohen në masa të natyrës strategjike të lidhura me funksionin e Rektorit, përkitazi me funksionimin e Universitetit në tërësi apo të ndonjë njësie të caktuar akademike;
 - J. MASHT, në afat prej tri javësh, do të formojë një grup ekspertësh me pjesmarrje ndërkombëtare, i cili do të monitorojë dhe do të këshillojë “zyrtarët e lartë të ngarkuar” në udhëheqjen e procesit të paraqitur në këtë dokument
- Ky grup do të zgjedh një kryesues nga anëtarët e vet. Raporte të rregullta për procesin e implementimit do t’i dorëzohen Qeverisë së Kosovës, MASHT-it, PSSP-së, AEU-së, Këshillit të Evropës dhe grupit të donatorëve.

Grupi i ekspertëve do të përbëhet prej:

1. Një ekspert i emëruar nga MASHT;
2. Një ekspert i emëruar nga Këshilli i Universitetit
3. Një ekspert i emëruar nga AUE;
4. Një ekspert i emëruar nga një OJQ vendore arsimore;
5. Një ekspert i emëruar nga OSBE;

K. Sekretari i përgjithshëm do të shërbejë si lidhje e këtij grupi nga “zyrtarët e lartë të ngarkuar”. Rëndësi e veçantë do t’i kushtohet rekomandimeve të grupit ndërkombëtar të ekspertëve lidhur me ri-zgjedhjet;

L. Të gjitha vendimet paraprake të Këshillit prej pesë anëtarëve do të shqyrtohen dhe konfirmohen sërish nga Këshilli i Universitetit;

M. Senati do të zgjedh një Kryesues të Përkohshëm në përputhje me Statutin, i cili do të kryesojë punën e Senatit deri në zgjedhjen e Rektorit të ri;

N. Të gjitha vendimet e Senatit dhe të Këshillave të Fakulteteve, të cilat janë miratuar para datës 1 dhjetor 2004, mbesin në fuqi si të vlefshme;

O. Të gjitha vendimet unanime të Senatit dhe të këshillave të fakulteteve, të cilët janë miratuar pas datës 1 dhjetor 2004, mbesin në fuqi si të vlefshme;

P. Të gjitha vendimet e kontestuara të Senatit dhe të këshillave të fakulteteve pas datës 1 dhjetor 2004, duhet të hyjnë në procedurë të shqyrtimit dhe miratimit të sërishëm;

Q. Rizgjedhjet do të organizohen nga “zyrtarët e lartë të ngarkuar” dhe do të zhvillohen në të gjitha rastet kur është vërtetuar mos-përputhja me kornizën ligjore në fuqi, pa vonesë dhe menjëherë pas kthimit të studentëve, do të monitorohen dhe do të përfundohen në afat prej 12 javësh në përputhje me procesin e mëtejshëm të implementimit të Statutit të UP-së;

R. Posti i Rektorit do të shpallet nga ana e “zyrtarëve të lartë të ngarkuar” në bashkërenditje me Senatin dhe duke u bazuar në tekstin e parë të shpallur në mediat e shkruara; kërkesat e mëparme do të mbesin të vlefshme dhe do t’i shtohen listës së kërkesave të reja për postin e rektorit;

S. Këshilli do të ndërmarr të gjitha masat e domosdoshme për të zhvilluar zgjedhje të përgjithshme studentore në pajtim me dispozitat e Statutit dhe në afat prej tre muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. Rezultatet e këtyre zgjedhjeve studentore do të implementohen në procedurën e rizgjedhjeve të dekretuara nga “zyrtarët e lartë të ngarkuar”;

T. Rektori dhe pro-rektorët do të zgjedhen nga Këshilli në pajtim me procedurat e përshkruara në Statut;

U. Mandati i “zyrtarëve të lartë të ngarkuar” do të përfundojë ditën e zgjedhjes së Rektorit të ri;

V. I tërë procesi i paraparë me këtë rregullore duhet të përfundojë brenda një periudhe jo më të gjatë se gjashtë muaj prej datës së hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. Në rast se disa procedura mbasin të papërfunduara pas kësaj date, MASHT do të nxjerr një udhëzim tjetër administrativ, i cili do të parashoh masat e duhura për përfundimin e procesit.

Ky udhëzim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Ministri.

Nënshkruar më 26 korrik 2005

Agim Veliu

Minister i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë